



BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2044 / Prot
3

Rrëshen më, 10 . 06 . 2024

V E N D I M

Nr. 48 datë 03. 06. 2024

PËR
“PËRDORIM FOND REZERVË - DHËNIE NDIHMË FINANCIARE”,
BASHKIA MIRDITË.

Në mbështetje të ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", në ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", në ligjin nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", në Udhëzimin nr.9, datë 20.07.2018, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", në Vendimin nr. 50, datë 15.12.2023, të këshillit bashkiak Mirditë, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024", relacionin për shpenzime të cermonisë mortore nr. 2044 prot, datë 22.05.2024, nga sektori i shërbimit social të bashkisë, së bashku me projektin e Kryetarit bashkisë, shqyrtuar në mbledhjen e datës 29.05.2024, në mbledhjen e komisionit të ekonomisë, financave dhe buxhetit, i propozon këshillit për miratim, me ndryshim të projektit nga shuma; 50 000 lekë në 100 000 lekë pas diskutimeve në mbledhjen e këshilli bashkiak;

V E N D O S I:

1. Të miratojë përdorimin e fondit rezervë, në shumën **100 000**, (njëqind) lekë, për dhënie ndihmë financiare, si vijon;
 - ✦ T'i akordohet ndihmë financiare familjes së të ndjerit; Gjin PULAJ, fshati Lëkundë, njësia administrative Selitë, për rast fatkeqësie (vdekje).
 - a. **Paksim:** Fondi rezervë;(A1133 00 2133001 01 V491AAA...604) në vlerën;...**100 000** lekë.
 - b. **Shtohet:** Pagesë;(AA133 00 2133001 01 V111AAA...606) në vlerën;.....**100 000** lekë.
2. Pagesa të kalojë në emër të kryefamiljares Znj. Flora Llesh PULAJ, mbajtëse e kartës identitetit H 36228069 G, në degën e Postës Mirditë, zyra Postare Rrëshen.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i bashkisë Mirditë, (drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe tatim taksat).

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor, nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.

SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al



ADRESA: SHËSHI "ABAT DOÇI", RRËSHEN

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

KRYETAR

Aleksandër PICAKU

www.bashkiamirdite.gov.al



Nr. 2044/2 Prot
Dt. 31.05.24

BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK
KOMISIONI I EKONOMISË, FINANCAVE DHE BUXHETIT

Relacion për projekt - vendimin
Nr. 2024/1 Prot, datë 27. 05. 2024



Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt - vendimin nr. 2044/1 prot, datë 27.05.2024, relacionit dhe dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin: Për "Përdorim fond rezervë", bashkia Mirditë.

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë!

Komisioni i mbledhur me datën 29.05.2024, shqyrtoi projekt vendimin nr. 2044/1 prot, datë 27.05.2024, relacionin dhe dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin: Për "Përdorim fond rezervë", bashkia Mirditë, paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt - vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni hartoi relacionin bashkëngjitur këtij vendimi, dhe me shumicë votash,

REKOMANDON:

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) Kalimin e projektaktit; në mbledhjen e Këshillit të datës 3 Qershor 2024, me një ndryshim vlerë monetare, nga 50 000 lekë i propozuar nga kryetari i bashkisë, të bëhet vlera 100 000 lekë. Nga 7 anëtarë në mbledhje, morën pjesë 5 anëtarë dhe u votuan 5 Vota PRO.

Ertor NDREU
(emri, mbiemri, firma)

Kryetar i Komisionit

Fran NDREJAJ
(emri, mbiemri, firma)

Zv.Kryetar i Komisionit

Aleksandër LUSHA
(emri, mbiemri, firma)

Anëtar

Albina VUKA
(emri, mbiemri, firma)

Anëtar

Brixhilda NOKA
(emri, mbiemri, firma)

Anëtar(mungesë)

Silva GJOMARKAJ
(emri, mbiemri, firma)

Anëtar(mungesë)

Leonard LLESHAJ
(emri, mbiemri, firma)

Anëtar

Konc. Gasper TOPOLLAJ

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRËSHEN

e-mail: keshilli@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al



BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI I BASHKISË MIRDITË

Nr. 2044 / Prot
1

Datë 27.05 / 2024

P/V E N D I M
Nr. 58 date 27.05.2024

“PËR PERDORIM FOND REZERVE ”

Mbështetur në ligjin 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin Nr. 9936 date 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", në ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", në ligjin nr.97/2023, "Per buxhetin e vitit 2024" "Udhëzimin Nr.9 datë 20.07.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", në udhëzimin nr.1, datë.24.01.2024, "Për zbatimin e buxhetit 2024", në VKB nr.50 datë 15.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024", në relacionin nr 2044 prot, datë.22.05.2024 e sektorit të shërbimit social të Bashkisë, këshilli i bashkisë Mirditë pasi diskutoi rreth projektit të paraqitur nga Kryetari i bashkisë;

V E N D O S I:

I-Të perdorë nga fondi Rezerve shumën 50 000 lekë, për dhënie ndihmë financiare si më poshte;

1.Të japë ndihmë financiare familjes së të ndjerit z.Gjin Pulaj, NJA Selitë për rast fatkeqsie(vdekje)

a-Paksim:fondi rezervë (A1133 00 2133001 01 V491AAA..604) për shumën 50 000 lekë
b-Shtohet (AA133 00 2133001 01 V111AAA.....606) për shumën 50 000 lekë

.2.Pagesa te kaloje ne degen e Postes Mirdite, zyra Postare Rreshen në emër të kryefamiljares zj.Flora Pulaj .

II-.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet sektori e finances dhe buxhetit.

III-.Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Gaspër TOPOLLAJ

KRYETARI
Aleksander PICAKU

Paraqiten projektin

Dr./zhvill ek dhe tatim taksat:: V.Gjoka

F.Fufi

Dr.Juridike, prok, protokoll: B. Dedaj

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 222162223www.bashkiamirdite.gov.al





Financa

AGJENCIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, ARSIMIT E KULTURËS
SEKTORI I NDIHMËS EKONOMIKE

Nr. 2044 Prot.

Rrëshen, më 22.05.2024

Lënda: Mbështetje financiare për shpenzime të ceremonisë mortore

Drejtuar: Kryetarit të Bashkisë dhe Drejtorisë së Financës

Familja Lazër Pulaj, me origjinë nga fshati Lëkundë, Njësia Administrative Selitë, aktualisht përbëhet nga tre anëtarë: nëna dhe dy djemtë, ndërsa tre anëtarë të tjerë kanë ndërruar jetë: kryefamiljari para dy viteve, e motra e tij para një viti, e cila ka qenë një person me aftësi ndryshe dhe djali 21 vjeç, i cili ndërroi jetë aksidentalisht muajin e kaluar, më 10 prill.

Dy vite më parë, pas vdekjes së kryefamiljarit, familja është transferuar me banim në Rrëshen, në një shtëpi me qera, duke menduar se do të përfitojë një shtëpi nga projekti i tërmetit, por për mosdijeni që kryefamiljari, në atë kohë, ka kërkuar që shtëpia t'i ndërtohet në Lëkundë, familja nuk ka përfituar ende shtëpi, pasi fëmijët nuk dëshirojnë të rikthehen në fshat. Nga Shërbimi Social është bërë një ankimim, në mënyrë që vendimi të ndryshojë, dhe të mundësohet ndërtimi i shtëpisë në Rrëshen.

Kjo familje jeton me të ardhurat që vijnë nga puna që bëjnë dy djemtë dhe nga nëna, e cila trajtohet me kemp të nivelit të lehtë. Aktualisht, kjo familje jeton tek lagja e ndërtimit, në një shtëpi me qera, të cilën e paguan me të ardhurat që përfitojnë nga puna.

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRËSHEN


email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al



Se fundmi, me fatkeqësinë që ju ndodhi, situata në këtë familje është rënduar edhe më shumë, në çdo aspekt, prandaj kërkojmë nga Bashkia Mirditë që të bëhet e mundur pagesa e shpenzimeve të bëra për ceremoninë mortore, pasi familja i ka mbuluar shpenzimet me borxhe.

Konceptoi: Adela Gjikota 

Miratoi: Drejtori Aurel Çupi 

Përgjegjës i Sekt.Soc. Gjergj Përgjoni

